

VENDIM
Nr. 600, datë 1.7.2015

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 27, DATË 14.1.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I LINJËS 110 KV ERSEKË-PËRMET"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 27, datë 14.1.2015, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"2. Shpronësimi të bëhet në favor të Operatorit të Sistemit të Transmetimit sh.a.".

b) Në listën e miratuar të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ky projekt, rreshti i fundit i tabelës, evidentuar me shtyllën nr. 192, bëhen plotësimet dhe saktësimet sipas të dhënave të përcaktuara në tabelën 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

c) Në listën e pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i linjës 110 kV Ersekë-Përmet, miratuar me vendimin nr. 27, datë 14.01.2015, të Këshillit të Ministrave, shtohet lista e pasurive të paluajtshme, me sipërfaqen prej 55.89 (pesëdhjetë e pesë pikë tetëdhjetë e nëntë) m², sipas të dhënave të përcaktuara në tabelën 2, bashkëlidhur këtij vendimi.

ç) Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në lekë, në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelat që i bashkëlidhen këtij vendimi, për sipërfaqen 2 383,76 (dy mijë e treqind e tetëdhjetë e tre presje shtatëdhjetë e gjashtë) m², tokë bujqësore, pyll, arë, kullotë, truall, vlerësuar në shumën prej 364 002,88 (treqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e dy presje tetëdhjetë e tetë) lekësh.".

d) Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"4. Fondi prej 364 002,88 (treqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e dy presje tetëdhjetë e tetë) lekësh të përballohet nga fondet e Operatorit të Sistemit të Transmetimit sh.a. (OST).".

dh) Pika 7 ndryshohet si më poshtë vijon:

"7. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme Ersekë, Kolonjë, Përmet dhe Gjirokastër të marrin masat për pezullimin e të gjitha transaksioneve mbi këto pasuri deri në përfundim të procesit të kalimit të pronësisë së pasurive të shpronësuara në favor të OST sh.a.".

2. Ngarkohen Ministria e Energjisë dhe Industrisë, OST sh.a., dhe zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

LISTA SHITESË E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I LINJËS 110 KV ERSEKË-PËRMET

Qarku Gjirokastrë
NB Përmet

Tabela 1

Nr.	Nr. shtyllës sipas projektit	Emri	Mbiemri	Lloji pasurisë	ZK	Nr. Pasurie	Sipërfaqja e shpronësimit m ²	Çmimi lekë/m ²	Vlera kompensimit/lekë
5	192	Gjergji Hektor	Rusha Rusha	truall	2917	12/40	21	797	16737

Qarku Korçë
Komuna Leskovik
Fshati VREPCKE

Tabela 2

Nr.	Nr. shtyllës sipas projektit	Emri	Mbiemri	Lloji pasurisë	ZK	Nr. pasurie	Sipërfaqja e shpronësimit m ²	Çmimi lekë/m ²	Vlera kompensimit/lekë
1	72	Xhelal Esat Luan	Mezini	Pyll	3826		16.59	85	1410.15
2	73	Xhelal Esat Luan	Mezini	Pyll	3826		19.65	85	1670.25
3	74	Xhelal Esat Luan	Mezini	Pyll	3826		19.65	85	1670.25
	Totali						55.89		4750.65